



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 153/ 2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Rafet Haxhaj kryesues, Xhevdet Abazi dhe Vlastimir Dimić, duke vendosur përkitazi për apelin e kompanisë ndërtimore “ARDA REI” me seli në Prishtinë, për ti hequr posterat e partive politike nga konstruksioni i urës të projektit “Ndërtimi i Rrethrotullimit në Rrugët Magjistrale M9^M2” në Prishtinë, në seancën e panelit të mbajtur me 16.02.2011, mori këtë:

V E N D I M

Hidhet poshtë si i pasafatshm apeli i kompanisë ndërtimore “ARDA REI”.

A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një apel më datë 09.02.2011, nga kompania “ARDA REI” në të cilin theksohet se kompania e lartcekur e ka pranuar një vendim nga PZAP-i më Anr. 88/2011 datë 26.01.2011, më te cilin është hedh poshtë si e pasafatshme ankesa e datës 19.01.2011 e kompanisë ndërtimore “ARDA REI”. Në apel më tej potencohet se problemi me heqjen e posterëve në projektin ndërtimi i rrethrotullimit në rrugën magjistrale M9^M2, nuk ka qenë i lidhur drejtpërdrejt me procesin zgjedhor dhe KQZ-ja në fillim i ka anashkaluar shkresat e kësaj kompanie pas paralajmërimit të parë dhe si pasoj e kësaj është zvarritur i tërë ky proces.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 8 paragrafi 5 parasheh:

Në lidhje me apelimin e një vendimi të KQZ-së, apeli duhet të dorëzohet brenda pesë ditëve pas njoftimit të KQZ-së. Për të gjitha apelet tjera, përveç nëse është saktësuar diku ndonjë afat tjetër, apelet duhet të dorëzohen brenda shtatëdhjetedy (72) orë nga pranimi i vendimit të PZAP-it nga parashtruesi/ja.

PZAP-i gjeti se;

- apeli është i pasafatshm

PZAP-i duke u bazuar në dispozitën e lartcekur ligjore ka gjetur se apeli është i pasafatshme për shkakun se nga shkresat e lëndës konstatohet se kompania "ARDA REI" vendimin paraprak lidhur më rastin në fjalë, më Anr. 88/2011 datë 26.01.2011 që është marrë nga PZAP-i, e ka pranuar më datë 27.01.2011, ndërsa apeli ndaj vendimit të PZAP-it Anr. 88/2011 datë 26.01.2011, është pranuar në PZAP më datë 09.02.2011. Për me tepër të gjitha apelet ndaj vendimeve të PZAP-it duhet të parashtrihen në PZAP brenda shtatëdhjetedy (72) orëve. Rrjedhimisht parashtruesi i ankesës nuk e ka shfrytëzuar afatin ligjor. Për këtë arsye si dhe bazuar ne dispozitën ligjore të cituar me larte dhe ne kuptim te nenit 115.1 te LPZ-se, PZAP vendosi si ne dispozitiv te këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 153/2011 më datën 16.02.2011

Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj

